PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.09.2026, ora 17:10 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Mirëseerdhët në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak ora 17:15.Ftoj sekretarin të bëj apelin.

Elsid Zyma-Sekretri I Këshillit Bashkiak Elbasan

Bën apelin.Prezent në sallë janë 41 antarë.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Për procedurë e kisha unë, kryetar. Propozoj që për këtë mbledhje ose të thërrasim Ramën dhe Spahun për të votuar pikën 13, ose e shtyjmë për në mbledhjen tjetër.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

1.Miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 9- kundër, 0- abstenim, miraton sa më sipër.

V.K(Y.Balliu,B.Copja,L.Hasa,A.Kana,D.Madhi,A.Marku,A.Mecja,R.Mita,

E.Murataj)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.09.2026, ora 17:10 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 2 e rendit të ditës

2. Për miratimin e përdorimit të një pjese të fondit të emergjencave civile për ndërtimin e godinës së stacionit të ri zjarrëfikës një Njësinë Administrative Bradashesh.

Gledian Llatja-Kryetari i Bashkisë Elbasan

Faleminderit, kryetar.Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,Më lejoni, në radhë të parë, të bëj një raportim mbi situatën e emergjencave civile në përgjithësi, por edhe të zjarreve, duke qenë se është edhe një nga temat e para që diskutohet sot: stacioni i ri i zjarrfikësve në Bradashesh.Dua t'ju informoj që gjatë këtij viti jemi pajisur me dy mjete të reja zjarrfikëse, të cilat kanë shërbyer shumë dhe na kanë ndihmuar në të gjitha rastet që kemi pasur të zjarreve apo të emergjencave civile në Bashkinë e Elbasanit, pasi janë të dyja mjete të pajisura me të gjitha ato që u duhen zjarrfikësve, edhe për aksidentet në rrugë, edhe për ndërhyrje në banesa, edhe për fikjen e zjarreve. Tashmë janë marrë në dorëzim nga stacioni i zjarrfikësve të Elbasanit dhe janë vënë në punë.Kanë qenë në shërbim gjatë gjithë kësaj periudhe, bashkë me të gjithë stafin zjarrfikës, sidomos gjatë periudhës së nxehtë të zjarreve.Gjatë kësaj periudhe kemi pasur gati 500 dalje gjatë këtij viti, 500 dalje nga stacioni i zjarrfikësve për emergjenca. Nga këto, 200 kanë qenë raste serioze, të cilat janë vlerësuar si të tilla, dhe 50 prej tyre kanë paraqitur rrezikshmëri për jetën e qytetarëve, të banorëve dhe për të mirat materiale, si në pyje, në kullota apo në pemë frutore dhe në banesa.Gjithashtu, kemi pasur tre zjarre në pyje, të cilat janë konsideruar të përmasave të tilla që është dashur ndërhyrja emergjente e zjarrfikësve.Ata kanë reaguar në një kohë shumë të shpejtë, bashkë me Ndërmarrjen e Punëve Publike Rurale dhe të gjithë stafin që ka qenë në zonat pyjore, kryesisht edhe me vullnetarët e njësisë administrative, për vënien nën kontroll dhe për fikjen totale të zjarrit, ku maksimumi i kohës për vënien nën kontroll ka qenë dy deri në tre orë. Ndërkohë, kemi pasur edhe një zjarr në zonën industriale, në një nga fabrikat e prodhimit të letrave të lagura dhe të letrës higjienike.Ai ka qenë një zjarr me përmasa të konsiderueshme, i cili është

konsideruar i rrezikshëm dhe ka sjellë dëme materiale për biznesin.Pavarësisht se biznesi ka qenë i pajisur me rezervat e tij ujore, përsëri zjarri ka pasur nevojë për ndërhyrjen e forcave zjarrfikëse të Elbasanit dhe të stacioneve pranë Elbasanit.Gjithashtu, stacioni ynë zjarrfikës ka ndihmuar në rastet e emergjencave që kanë pasur edhe bashkitë e tjera, duke filluar me Bashkinë e Krujës, Bashkinë e Tiranës, Bashkinë e Fierit dhe Bashkinë e Himarës.Gjatë gjithë kësaj periudhe ka qenë në ndihmë sipas kërkesave që janë bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile. Gjithashtu, këtë vit presim të pajisemi edhe me dy mjete fuoristrada.Njëri prej tyre është i pajisur për zonat pyjore me bot uji, ndërsa tjetri është për transportimin e stafit të zjarrfikësve.Gjithashtu, presim që këtë vit, pas procedurave , shpresojmë që të përfundojmë shpejt procedurat e prokurimit , të pajisemi për herë të parë me një kamerë termale, me një stacion kamerash termale për evidentimin e zjarrit në kohë reale, nëpërmjet sistemeve teknologjike.Gjithashtu, kemi aplikuar edhe për projekte të tjera dhe presim që t'i implementojmë këtë vit, në mënyrë që viti tjetër të jetë një vit me më shumë teknologji për kontrollin e zjarreve, evidentimin e tyre, por edhe monitorimin e personave të cilët shpeshherë vendosin zjarre të qëllimshme.Këtë vit do ta konsideroja , pavarësisht se vala e të nxehtit nuk ka kaluar, do të jetë edhe shtatori me temperatura të larta dhe tetori gjithashtu pritet të ketë temperatura të larta ,por doja të thosha që deri tani kemi pasur një situatë të qetë për sa u përket zjarreve të mëdha, sidomos në zonat pyjore.Është konsideruar, në fakt, si një vit i mirë për menaxhimin e zjarreve. Kjo edhe për shkak të rritjes së numrit të zjarrfikësve dhe të stafit të tyre.Nuk kemi pasur më problematika me pjesën e mjeteve apo të stafit.Gjithashtu është kërkuar të hapet një stacion i ri zjarrfikës në zonën e Bradasheshit.Në mbledhjen e kaluar kemi miratuar shtimin e një numri prej 10 vetësh. Shkresën e kemi çuar te Emergjencat Civile dhe gjithashtu te Ministria e Financave për rialokimin e fondeve për forcat e reja zjarrfikëse, të cilat duam t'i shtojmë në zonën e Bradasheshit. Gjithashtu, nga verifikimet e bëra në terren është vendosur që stacioni të vendoset pranë njësisë administrative.Është parë e udhës edhe nga ekspertët e Emergjencave Civile dhe të drejtorisë përkatëse që të ndërtohet, pranë Njësisë Administrative Bradashesh, në pronë shtet, një kapanon i vogël për mjetin zjarrfikës, i cili duhet të jetë në kushte standarde ruajtjeje, si dhe ambientet e shërbimit për punonjësit e stacionit zjarrfikës që do të jenë në Bradashesh. Ne kemi ambiente në Njësinë Administrative Bradashesh, por është parë e domosdoshme nga ekspertët e zjarrfikëses, të cilët kanë kërkuar që të bëhet një kapanon i posaçëm vetëm për zjarrfikësen dhe për stafin e zjarrfikësve.Aty do të përfshihet edhe dhoma e fjetjes për punonjësit e zjarrfikëses dhe ambientet e tjera të shërbimit. Kjo është propozuar nga Fondi i Emergjencave Civile për t'u rialokuar dhe për t'u vendosur në shërbim të ndërtimit të stacionit të ri zjarrfikës në Bradashesh.Faleminderit.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Në fakt, kur mashtrohet publikisht edhe në sytë e anëtarëve të Këshillit, minimalisht duhet të ketë pak stil. MZSH-ja e Elbasanit ka tre vjet që s'ka sektor parandalimi. Nuk ekziston ende. Nuk është miratuar, që nga momenti kur dha dorëheqjen, oficeri i parandalimit dhe shefi i sektorit.E para kjo.E dyta, sa i përket politikave për mbrojtjen nga zjarri, serioziteti i kësaj bashkie duket që kur merr dy mjete të reja nuk i referohet kartelës së mjetit, duke qenë se është i ri, por vjen këtu dhe na bën sot, në një pikë tjetër të rendit të ditës, përcaktimin e normave dhe kritereve, ndërkohë që mjetet janë të reja. Për të vazhduar me trajnimin e stafit dhe personelit të mbrojtjes nga zjarri në këtë bashki.Ju sot po thoni që do ndërtoni një repart të ri. Ky repart, pikë së pari, kërkon që t'i përgjigjet nevojave të asaj zone ose, më saktë, të disa njësive administrative që prek Bradasheshi deri në kufi me Paprin apo më tej, këtej nga Balca.A i përgjigjet? Unë mendoj që jo.Ju keni staf të trajnuar. Të bësh kapanone, të bësh rafte, të vendosësh karrige dhe tavolina për të qëndruar militantë të partisë, që kanë një bluzë dhe quhen punonjës të shërbimit zjarrfikës, nuk do të thotë që t'i shërbesh komunitetit.Në fakt, një gjë tjetër që mua më bëri përshtypje te parashtrimi që bëri ky zotëria është fakti që përmendi zjarret që kanë rënë këtë vit dhe masat që pretendohet se do merren. Po nuk ka si të merren masa. Ju do ta shisni çdo pronë të Elbasanit në "Paketën e Maleve", sepse prona private nuk të lejon ty që të kesh parandalime.E dini pse?Sepse përpara katër muajsh VKM-ja nr. 424 për mbrojtjen nga zjarri, është abroguar.Nuk kemi rregullore sot.Me çfarë normash ky shërbim i zjarrfikësve këtu miraton projektet e mbrojtjes nga zjarri?E dini ju që sot, për miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri, nuk ka fare normativë se sa fikëse zjarri duhen në një objekt, sa hidrantë duhen, a ka apo s'ka shkallë emergjence?Një nga ato shtatë firmat e lejes së ndërtimit. Do thoni juve që po i çoni të gjitha me këtë Agjencinë e Zhvillimit të Territorit, me AZHT-në.Po normal që ashtu do katandiset, sa kohë Bashkinë e Elbasanit e keni katandisur në një karakatinë, e cila nuk prodhon asgjë më. As leje ndërtimi s'po prodhoni dot.Dhe bëni mirë, po bëni shumë mirë që të paktën për këto objektet ku do të grabisni ndonjë lek tjetër, si puna e repartit zjarrfikës, jepni leje ndërtimi.Po jepni leje ndërtimi edhe për qytetarët, jo vetëm për të vetët tuaj për pallate.

Bjanka Copja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Përshëndetje.Si fillim duhet të jemi të qartë që nuk po diskutojmë se jemi kundër ndërtimit të një stacioni zjarrfikës, por mbi të gjitha jemi kundër përdorimit të Fondit të Emergjencës Civile për rikonstruksion apo ndërtim-godine.Fondi i Emergjencës Civile ka një qëllim shumë të qartë: të përdoret në situata emergjente dhe jo për mungesën e planifikimit të bashkisë në ndërtime apo rikonstruksione godinash. Nëse kjo ka qenë e nevojshme, pse nuk është planifikuar që në buxhet ky ndërtim,Ose, edhe më e qartë, tashmë mund ta shtyjmë në buxhet. Viti po mbaron.

Në dhjetor planifikohet buxheti i ri.Atëherë nuk kemi pse prekim Fondin e Emergjencave Civile, sepse nuk mund të përdoret si një rubrikë buxhetore sa herë ju duhet një investim i ri. Do t'ju lutesha me të vërtetë shumë që këtë fond emergjent të mos e prekni, sepse, në një situatë emergjente, Elbasani më pas nuk ka mundësinë të përballojë asnjë problematikë madhore.Faleminderit.

Gledian Llatja-Kryetari i Bashkisë Elbasan

Fondi i Emergjencave Civile përdoret për këto raste. Pra, është përdorur edhe në vitin e kaluar për blerjen e mjeteve zjarrfikëse, për pasurimin e fondit.Është tipike për emergjencat civile.Faleminderit. Nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me stacionin aty.Ne e kemi stacionin, stacionin e Elbasanit. Ky është stacioni i ri që po hapet dhe, kur të hapet stacioni i ri, nuk do të jenë vetëm punonjës të rinj që do të shkojnë aty, por do të jetë një miks: edhe punonjës të vjetër me eksperiencë, edhe punonjës të rinj. Stacioni është i pavarur nga pjesa e zjarrfikësve.Për zjarrfikësit do të hapet thirrja kur të miratohet.Po presim miratim nga Ministria e Financave. Emergjencat Civile kanë procedurën e vet për t'u shtuar numri.Pra, ne kemi bërë propozimin. Pas miratimit të Këshillit Bashkiak dhe pasi të bëhet rekrutimi, do të bëhet edhe trajnimi i stafit. Është pa lidhje me godinën. Ne sot, në fakt, kemi gati tre muaj që e mbajmë stacionin zjarrfikës në Bradashesh dhe në Labinot-Fushë.Në qoftë se e keni vënë re, për shkak edhe të trafikut të rënduar që mund të ketë gjatë muajve të verës, ne i kemi vendosur mjetet zjarrfikëse edhe në Bradashesh, edhe në Labinot-Fushë. Pikërisht për të pasur një kohë reagimi më të shkurtër për ato zona.Bradasheshi, për shkak të emergjencës, autostradës dhe rrugës nacionale dhe aksidenteve që mund të ndodhin në aksin Elbasan–Papër dhe Elbasan–Tynel, por edhe për pjesën e zonës industriale dhe të gjithë fondit pyjor, zonës së Zaranikës, që kap Paprin, Gracen, Funarin, kërkon një ndërhyrje më të shpejtë në ato zona, në mënyrë që të jetë më efikase. Ne sot i kemi mjetet të dislokuara atje.Ky është stacioni.Nuk është se ka lidhje domosdoshmërisht me pjesën e numrit të punonjësve.

Zamir Muzhaqi-Nënkryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

E kuptoj unë.Unë i referohem relacionit që i është paraqitur Këshillit Bashkiak muajin që kaloi.Sipas relacionit që u paraqit muajin që kaloi, ishte e lidhur kërkesa për punonjës shtesë me hapjen e pikës së re. Atij unë i referohem, sepse na del një problem pastaj: ku do t'i çojmë këta dhjetë?Ti thua: "Unë kam gjetur vendin", ndërkohë që shumë bukur një muaj më përpara mund të na thoshe që ne na duhen dhjetë, dymbëdhjetë punëtorë të rinj.

Gledian Llatja-Kryetari i Bashkisë Elbasan

Ne jemi të gjithë koshientë që numri i zjarrfikësve tanë është shumë herë poshtë normativës që duhet.Jemi poshtë kapacitetit ligjor për numër banorësh në raport me numrin e zjarrfikësve që kemi.Edhe nuk është domosdoshmërisht e lidhur.

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, 9- kundër, 1- abstenim, miraton sa më sipër.

V.K(Y.Balliu,B.Copja,L.Hasa,A.Kana,A.Marku,A.Mecja,Z.Muzhaqi,E.Muzhaqi

E.Murataj)

~~V.A(R.Mita)~~

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

~~Sekretar I Këshillit Bashkiak~~

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.09.2026, ora 17:10 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 3 e rendit të ditës

3. Për një shtesë në vendimin 16 datë 29.01.2025 "Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorike në administrim të ASHPR."

Gledian Llatja-Kryetari i Bashkisë Elbasan

Janë blerë mjete të reja si mjete tek ndërrmarrja e punëve publike tek zonat rurale dhe bashkia elbasanit rinovon flotën e saj dhe merr mjete të reja është marrë dhe një mjeti ri i cili kërkon normativën dhe është bërë dhe transferimi i dy korseve të barit nga drejtoria e arsimit tek ASHPR është thjesht pjesë normative.

Këshilli Bashkiak me 29 vota pro, 7- kundër, 4- abstenim, miraton sa më sipër.

V.K(Y.Balliu,A.Kana,D.Madhi,A.Marku,Z.Muzhaqi,E.Muzhaqi

E.Murataj)

V.A(R.Mita.L.Hasa,B.Copja,A.Mecja)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.09.2026, ora 17:10 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 4 e rendit të ditës

4. Për shtesën e numrit të punonjësve të Agjensisë së Shërbimeve Publike Rurale si dhe Policisë bashkiake të Bashkisë Elbasan.
Gledian Llatja-Kryetari i Bashkisë Elbasan

Në ndërrmarrjen e punëve publike rurale sidomos në investimin e fundit që është bërë në qendër te Gjinarit,është kërkuar dhe shihet e sdomosdoshme nga ne dhe nga pjesa e bonorëve që të shtohet mirëmbajtja i cila deri tani ajo është mirëmbajtur nga ndërmarja e punëve publike rurale të cilat shkonin në Nj.Adm Gjinar për pastrimin e barit mirëmbajte të ndryshme dhe këndin sportive në Gjinar.Është parë nga ne të shtohet një numër punonjësish që të jetë dhe për pjesën e infopointit dhe për pjesën e qëndrës së gjinarit,dhe të shërbime të tjera të pastrimit që kërkohen në Nj.Adm gjinar.Gjinari nga një zonë rurale tashmë është kthyer në një destinacion turistik ku vazhdojnë dhe happen bujtina kemi një numër të konsederueshëm turistësh ashtu sic kemi dhe në nj,adm Tregan ku dhe atz kërkohet që të vendoset një punonjës,duam të vendosim dhe një punonjës tjetër për pastrimin,gjelbërimin dhe punët e tjera që kërkohen në nj.adm Tregan.Janë të dyja zona turistike për Elbasanin dhe kërkojnë një vëmëndje dhe një mirëmbajtje perjodike të tyre.Para disa kohësh ka kaluar me vendim të Këshillit të Ministrave rruga nga rreth rrotullimi Bradasheshit deri tek dalja e qytetit të Elbasanit, ka kaluar në Bashkinë e Elbasanit gjithashtu dhe rruga sekondare Elbasan-Metalurgji ,nga ura e zaranikës der tek rrethrrotullimi Bradasheshit tek të dyja kto rrugë kërkohet një shtim punonjësish për mirëmbajtjen e tyre perjodike meqë janë rrugë me fluks automjetesh dhe me një sipërfaqe të konsiderueshme e cila kërkon në vazhdimësi mirëmbajtjen e tyre.Në këto rrugë fusim dhe pjesën e pastrimit perjodik.Në ndërrmarrjen e punëve publike rurale është kërkuar një shtesë e numrit të punonjësve pa ndryshuar buxhetin.Gjithashtu dhe për policin bashkiake,kërkohet dhe këtu me fillimin e vitit të ri dalëndyshk dhe me pjesën e ngarkesës që ka për pjesën e monitorimit të shitësve ambulantë të parkimeve në lagje,kërkesës së vazhdueshme dhe problematikave që kemi pasur në zonat tona të brëndëshme të qytetit sidomos në lagjet kryesore,për pjesën e parkimit sidomos për

parkimin e rezidentit ku tashmë jemi fokusuar në lagjet kryesore të qytetit.Është kërkuar një menaxhim më i mirë,dhe kjo kërkon dhe një rritje të numrit të punonjësve të policisë Bashkiake duke theksuar që punonjësit e policis bashkiake punojnë dhe me tre turne.Kemi dhe aktivitete të ndryshme ku kërkohen dhe në njësitë administrative ku organizohen tregjet për praninë e punonjësve të policisë Bashkiake.

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Sa më shumë shtohen gropat në qytet,sa më shumë ndotet ajri në qytet sa më shumë fshihen vizat e bardha në qytet sa më shumë nuk realizohen to projekte që dhe i kemi bashkëvotuar ktu në Këshill Bashkiak flas për parkimet e rezidentit aq më shumë shtohet numri i punonjësve dhe aq më shumë fuqëzohet agjencia e shërbimeve rurale,me sa di unë jetoj brënda vijës së verdhë dhe nuk arrij të konceptoj se pse cdo shërbim dhe cdo aset dhe mbi të gjitha asete më të rëndëshishme që ka bashkia e Elbasanit dhe financa ja adreson agjencisë së shërbimeve rurale.Unë arrij ta kuptoj pse po ndodh jemi afër vitit elektoral,diku nga janari nuk do ju lejohet më të punësoni as të transferoni asete por di dhe mbaj mend shumë mirë që kam qënë një nga partizanet për pajisjen e rezidentëve me pullën e parkimit,nuk e kamë parë askund.Keni vënë në hyrje të kalëse që në 31 korrik një tabelë ndalim qarkullimi për ato që nuk janë rezidentë,ndërko që ato vazhdojnë qarkullojnë.Unë e kuptoj që aty ka dy biznese,mund të vini tahun pas ktyre të dyjave dhe të vazhdojë të qarkullojë vetëm rezidenti aty brënda mos flasim nëpër lagje që situate është bërë kaotike sidomos dhe nëpër lagjet që ka dhe tregje.E ke bërë ndonjëherë llogarin kryetar me gjithë lejet e ndërtimit që ke dhënë në raport me banesat që janë shitur sa parkime ka Elbasani të akseshueshme sepse tek zona e stadjumit ke vetëm atë të stadjumit me pagesë ndërsa rreth e qarkë e ket ë gjithë bulevardin me bizneset që kanë blerë parkimin qe paguajnë tarifën vjetore.Po qytetarët e thjeshtë,në fakultetin e drejtësisë nuk hyn dot dhe kur je punonjës se njerzit skanë faj,sdinë ku ta parkojnë,situate është kaotike.faleminderit për vijat e bardha që kishit bë tek gurabardhi aty ku përdit rrrezikohet jeta e njerzve,dhe ju vazhdoni shtoni numrin e punonjesve.

Ergys Muzhaqi-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Vazhdimisht kërkoni shtesë vende pune,jeni në gjendje të argumentoni dicka.Unë mund të kapem me shumë gjëra të tjera në qytet para shumë pak kohësh që përkonte me fushatën e zgjedhjes u fut një fushatë nga kryeministri dhënie dorëheqjesh nga personeli bashkisë nënkryetarë,drejtore,heqje e hapsirave publike njerëz që kishun bërë më miljona lekë investim thjesht hoqën etrata përsëri hapsira publike është e zënë,nuk ka zonë të qytett agje ku mos kesh hapsira publike të zëna,ku mos kesh

parkime dyshe.tregjet janë problematike nga fillimi deri në fund.Mbaroi fushta që do lirohen hapsirat publike,u zunë prap hapsirat publike nga rruga namazgjasë der tek kryqëzimi cërrikut plot nëpër lagje plot të gjithë shumica e qytetarëve që marrin dyqani buzë rrugës i kanë vetëm për magazina të gjithë aktivitetin tregtar e bëjnë në trotuar.Ju kto i kërkoni vetëm si numër duam puntorë policie bashkikaë,duam puntorë për të rreguluar rrugën dhe kto janë vetëm për fushatë për të bërë incvestim në rroga që të mbani njerëz për zgjedhje.Nëse do të kishit një administratë personel që e keni shumë të ngarkuar të bashkisë Elbasan me menaxhim efikas ju duhet të hiqnit njerëz nga puna sepse aq sa është Elbasani dhe aq sa po shpopullohemi se ku do i coni ju të gjithë këto njerëz që fusni në punë përvecse ti bëni gati për zgjedhjet e ardhshme un nuk di ta jap ktë përgjigje.Policia Bashkiake marren me njerëz që pse kan zënë një trutar kur të gjithë trutuarët janë të zëna ske ku të kalosh.Ju do ta bëni punën un ju kuptoj nuk ka mundësi që unë të jem përfaqësues dhe tju them ju vazhdoni për të gjitha kto shpërdorime vetëm për paga njerëzish që i keni për zgjedhje.Nuk keni efikasitet fare.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë kisha një ndërhyrje tjetër kto kolegët ezauruan shumë nga ato që doja të thoja ose që mund të thuhen se kisha për të thënë dicka tjetër mir bëni që I shtoni kta të policis bashkiake dhe bën shumë mirë që shton dhe kto të ASHPR-së se po bëheni gati për bujtina po I rrëmbeni tokën banorëve kaq vjecar të gjinarit ër të bërë vila për vete.Unë kam një sugjerimmos harxhoni kot lekë nëpër vila se disa prej jush do kënë disa muaj për të kaluar në qeli

Rudina Mita-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Duke parë shkresën vë re dicka që mund të jëtë dhe lapsus ktu shikoj 12 punonjës shtesë për ASHPR në project vendimin që do të marri Këshilli Bashkiak shukij 10 punnjës shtesë pra gjithsej 12 ktu ke faqja parë e relacionit dhe projektvendimi shtesë prej 10 punonjës në ASHPR.Pra nga 177 punnjës shkon 187 punonjës.Një shofer tre punonjës në sektorin e pastrimit dy në njësin adm,një punonjës në njësin adm dhe pesë punonjës të rjerë pra I bie 12 punonjës.

Gledian Llatja-Kryetari i Bashkisë Elbasan

Janë 10 punonjës mbas konsultimit dhe me stafin.Sa herë që kërkohet dicka e re për punonjës bëhen analiza kërkohen personate rinje për shtim organike fadroma nuk punon pa shofer makina nuk punpjnë pa shofer për sa kohë në fuqëzojmë ASHPR për punët në fshatra kërkohet që të pasurohet dhe me shtesën e personelt mbështetës.Dhe gjinari dhe Tregani ka nevoj për punonjës mirëmbajtje të jënë atje gjatë gjith kohës për sa kohë ka turista por edhe jashtë sezonit.Në qytet punët

vahdojnë normalisht ka pas dhe ka ngarkese sidomos gjatë verës për sa i përket dhe prodhimit nga zonat rurale që vinë dhe shesin në qytet.Ka pasur dhe masa të marra nga policia Bashkiake gjoba të vendosura dhe është një problematik,kemi marrë masa dhe pët ato që shesin në kala.Eshtë mbajtur në kontroll pjesa e ambulantëve të vegjël.

Këshilli Bashkiak me 29 vota pro, 11- kundër, 1- abstenim, miraton sa më sipër.

V.K(Y.Balliu,A.Kana,D.Madhi,A.Shtylla,Z.Muzhaqi,E.Muzhaqi

E.Murataj,B.Copja,L.Hasa,M.Kaculi,A.Mecja)

V.A(R.Mita)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.09.2026, ora 17:10 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 5 e rendit të ditës

5. Rritje e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e vitit 2026, me burim financimi të huaj.

Shefqet Bullari-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Në bazë të marrëveshjes së Bashkisë Elbasan me Bashkimin Evropian është lidhur një marrëveshje e cila ka të bëjë me partneritetin lidhur me projektin administrate publike përballet me transformin digital si komunitet programin IPA sipas marrëveshjes alokimi i fondeve bëhet në tre këste dhe aktualisht është kësti i tretë për shumë 1 miljon e 980 563 64 lekë në respektim të marrëveshjes do të alokohen në rritjen e të ardhurave të Bashkisë që do të shkojnë për paga,sigurime shoqërore dhe shpenzime operative sepse ashtu është dhe marrëveshja me donatorin pra kemi rritje të ardhurash dhe rritje shpenzimesh që do të kalojnë për paga.Administata publike do të përballet me transformim digital.

Gledian Llatja-Kryetari i Bashkisë Elbasan

Projektet e Bashkimit evropin synojnë rritjen e kapaciteteve të Bashkisë së stafit të Bashkisë Elbaan për transformimin digital dhe shërbimeve për qëllim me afromin e bashkimit evropian dhe qasjen ndaj fondit të korezionit është një nga kto projekte ku bashkimi evropian nëpërmjet programeve adrion mbështet stafin e bashkisë Elbasan me një pjesë të trajnimeve dhe të shërbimeve që kryen.

Ergyz Muzhaqi-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Meqë jemi tek investimet e huaja Zoti Llatja ju kam bërë një pyetje të cilës nuk mi keni dhënë përgjigje as me shkrim as me gojë dhe pse keni thënë që do të më përgjigjeni.Cilat janë të Elbasanit mbas 31 marsit kanë 24 orë një?

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, 3- kundër, 7- abstenim, miraton sa më sipër.

V.K(B.Copja,L.Hasa,E.Murataj)

V.A (Y.Balliu,A.Kana,D.Madhi,A.Mecja,R.Mita,Z.Muzhaqi,A.Shtylla)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.09.2026, ora 17:10 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 6 e rendit të ditës

6.Detajim i fondit për shpërblimin e punonjësve të SHMZSH.

Këshilli Bashkiak me 33 vota pro, 2- kundër, 4- abstenim, miraton sa më sipër.

V.K(B.Copja,E.Murataj)

V.A (Y.Balliu,A.Kana,D.Madhi,A.Shtylla)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 10.09.2026, ora 17:10 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Z.Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika e 7 e rendit të ditës

7.Transferim fonde në buxhetin e vitit 2026 dhe periudhën afatmesme 2027-2028 si dhe detajim i shtesës së grantit.

Gledian Llatja-Kryetari i Bashkisë Elbasan

Doja të bëja dhe një përshkrim të relacinit ku një nga fondet kryesore të cilat rialokohen janë për shkollat e reja në Bashkinë e Elbasanit,i uroj suksese të gjithë nxënësve të cilët fillojnë mësimin në shtator dhe atyre 924 të cilët për herë të parë hyjnë në bankat e shkollës.Ky vit i ri akademik elbasanin e gjen me tre shkolla të reja shkolla Dhaskal Todri,me shkollën e Shushicës,me prodhimin vet të energjis elektrike me termoizolim gjithashtu hapet dhe shkolla e re Zëra Jete n ëish godinën e shkollës Fadil Gurmani per 55 nxënës me aftësi speciale.Gjithashtu vazhdojnë punimet në shkollën Naim Frashëri me rikonstruksionin total të shkollës dhe të ambjenteve të palestrës.Hapet në datë 14 dhe cerdhja nr 5 dhe fillojnë punimet për cerdhen nr 6.Fillojmë shumë shpejtë punimet dhe rialokohet fondi për godinat e reja të shkollave me bashkëfinacim të ministris së arsimit do të kemi shkollën Abdyl Paralloi,e cila është shkollë në qëndër të qytetit e cila do të rikonstruktohet totalisht dhe Godina e re e kopshtit që do të ndërtohet pas shkollës Abdyl Paralloi,gjithashtu kemi shkollën Sul Misiri e cila është dhe ajo me problematika të theksuara infrastrukturore dhe do të filloj rikonstruksioni total me bashkëfinacim me ministrin e arsimit,dhe gjimnazi Vasil Mbrënda një viti ne përfundojmë tre shkolla.Një pjesë e madhe e buxhetit shkon pëe shkolla,kopshte dhe cerdhe.Eshtë rikonstruktuar totalisht cerdhja nr.2 dhe po planifikohen një sërë masash dhe për disa kopshte në Bashkinë e Elbasanit.Regullojmë një pjese të infrastrukturës arsimore sigurisht që kemi nevoja akoma në shkollat tona.Kjo kërkesë që është bërë për rialokimin e fondeve në fillim të vitit ne kemi miratuar një sërë rrugësh rurale për investim projektet janë punuar janë detajuar ka pasur nevoj për shtimin e veprave të artit në disa prej tyre dhe përfundimi i projekteve përfundimtare dhe përfundimi i prokurimit

kërkohet dhe rialokimi i fondit.eshtë parë një pjesë e buxhetit nga tepricat e mbetura apo që shihen më të vështira për pjesën e prokurimit është bërë rialokimi i këtyre zërave dhe është kërkuar nga këshilli Bashkiak që të shtohet vlera e disa rrugëve rurale ata që janë miratuar dhe kërkohet shtesa e buxhetit për shkak të përfundimit të projektit.

Altin Mecja-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Para disa ditësh kam bërë një kërkesë për informavion mbi gjëndjen e institucioneve arsimore nuk ka ardhur Akoma por dua të di sa shkolla lyeni në vit si institucion.90% e shkollave lyhen nga vetë mësuesit.

Gledian Llatja-Kryetari i Bashkisë Elbasan

Janë bërë sipas kërkesave që kanë sjellë shkollat janë bërë lyerjet dhe rregullit e shkollave kanë mirëmbajtje të rregullut ,nuk lyhet cdo klasë apo cdo shkollë cdo vit .Nuk lyhen dot 116 struktura të shkollave në Elbasan kanë ciklin e vetë perjodik dhe sipas kërkesave të shkollave.

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

